

KOMUNA E GRAÇANICËS 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Komuna e Graçanicës udhëhiqet nga Vlladeta Kostiq i cili përfaqëson subjektin Lista Serbe. Ai ka ardhur në pozitën e kryetarit pas dorëheqjes së ish-kryetarit Branimir Stojanović. Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Graçanicë janë zhvilluar në janar 2015. Kostiq ka fituar në raundin e parë me 67% të votave. Kandidati i dytë me i votuar ka qenë Nenad Rashiç nga Partia Demokratike Progresiste.

Sipas një studimi të UNDP-së, 90% e qytetarëve të Graçanicës konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.¹ Ndërsa kjo komunë sipas matjeve të UNDP-së ka dalë me shkallën me të ulët të kënaqshmërisë me punën e kryetarit të komunës, ku vetëm 2% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur.² Të kënaqur në Graçanicë nuk janë shprehur qytetarët as me administratën komunale, Kuvendin Komunal dhe mënyrën e shpenzimit të mjeteve buxhetore nga ana e komunës. Mesatarja e të kënaqurve në këto fusha nuk kalon 4%.

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Graçanicës. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm, mungesa e objektit shkollor në Kishnicë, rrugët e dëmtuara dhe mos mirëmbajtja e tyre, qentë endacak, dhe mungesa e ndriçimit publik në shumë zona.³

¹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

³ Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Graçanicës 2013. Burim: <http://bit.ly/2wLvO4n>

Problemet aktuale të Komunës së Graçanicës

Mungesa e hapësirave për parkim të veturave

Në Komunën e Graçanicës në shumë zona veçmas në ato urbane ka mungesë të parkingjeve për vetura. Kjo mungesë krijon tollovi të ndryshme dhe nuk kanë qenë të pakta edhe rastet e konflikteve mes banorëve për shkak të parkingut.

Derdhja e kanalizimeve në lumin "Graçanka"

Të gjitha kanalizimet fekale dhe atmosferike në Komunën e Graçanicës derdhen në lumin e qytetit. Derdhja e këtyre kanalizimeve vlerësohet të ndikojë në ndotjen e rrjedhës së lumit dhe në përhapjen e erës së keqe dhe insekteve. Kjo gjendje është e tillë edhe brenda qytetit të Graçanicës. Ky problem do të mund të evitohet me rregullimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza.

Prezenca e madhe e qenve endacak

Qentë endacak paraqesin shqetësim për banorët e Komunës së Graçanicës. Prindërit detyrohen t'i përcjellin fëmijët e tyre për në shkollë nga frika e qenve endacak.

Mungesa e hapësirave sportive dhe këndeve për fëmijë

Komuna e Graçanicës në të gjitha zonat ka mungesa të hapësirave rekreative, veçmas të këndeve për fëmijë. Komuna do të duhej t'i kushtonte vëmendje kësaj sfare dhe në të ardhmen të parashihte krijimin e kushteve për rekreacion dhe sport së paku në zonat kryesore të qytetit.


Pamundësia e komunës për ta kontrolluar sistemin shëndetësor dhe atë arsimor

Komuna e Graçanicës nuk ushtron asnjë kompetencë ndaj sistemit arsimor dhe atë shëndetësor në komunë. Këto dy fusha i menaxhon komuna paralele që është e vendosur në këtë qytet dhe kontrollohet e financohet nga ana e Qeverisë së Serbisë. Pamundësia për t'i kontrolluar këto sisteme ka bërë që komuna të mos mund të llogarisë në cilësinë e shërbimeve shëndetësore, ose mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor.

Trendet buxhetore në Komunën e Graçanicës (2017)

Komuna e Graçanicës në vitin 2017 ka planifikuar 7.1 milion euro buxhet.⁴ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013, Komuna e Graçanicës ka pasur një rritje afro 1.4 milionë euro të buxhetit. Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe rreth 378 mijë euro tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara,⁵ ndërsa në vitin 2013 janë bartur rreth 645 mijë euro, pra 267 mijë euro më shumë sesa këtë vit.⁶

Figura nr.1:Buxheti i Komunës së Graçanicës 2017




Në bazë të grafikonit të mëposhtëm shohim se Komuna e Graçanicës vazhdimisht ka pasur rritje të shpenzimeve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ndërsaq investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, por gjatë viteve të fundit është shënuar rritje dhe kjo vërehet edhe me një rritje të konsiderueshme nga viti 2013 në vitin 2017.

⁴ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

⁵ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63

⁶ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Burimi: <http://bit.ly/2wKArjf>, faqe 60

Figura nr.2: Trendët buxhetore në Graçanicës 2013 dhe 2017




Kategoria e pagave dhe mëditjeve është rritur nga afro 2 milionë euro në 2013 në afro 2.6 milionë euro në 2017. Kjo rritje mund të ketë ardhur nga vendimi i kryeministrit në vitin 2014⁷ për të rritur pagat për 25% në sektorin publik. Graçanica po ashtu ka kontraktuar 10 punëtorë me kontrata për shërbime të veçanta.

Në kategorinë e investimeve kapitale të planifikuara, Graçanica ka pasur rritje afro 500 mijë euro, por pjesëmarrja në buxhetin total për vitin 2017 dhe për vitin 2013 ka mbetur me përqindje të njëjtë. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve është zvogëluar duke ulur pjesëmarrjen në buxhet për 8 pikë përqindjeje. Ndërkaq ajo e shpenzimeve komunale është rritur duke ngritur pjesëmarrjen në buxhet për një pikë përqindjeje. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve është zvogëluar për afro 89 mijë euro dhe pjesëmarrja në buxhetin total të komunës është 3%, ndërkaq para katër vitesh ishte 5%.


⁷ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M>

Figura nr.3: Përqindja e pagave dhe investimeve kapitale në buxhetin e vitit 2017



Komuna e Graçanicës gjatë vitit 2016 ka realizuar të hyra në vlerë prej afër 1.4 milionë euro. Kjo shumë është dukshëm më e vogël se të hyrat e realizuara një vit më herët, ndërkaq dallon vetëm për rreth 7,500 euro me të hyrat e vitit 2013. Kategoria kryesore e të hyrave në Graçanicë është ajo nga tatimi në pronë.

Figura nr.4: Të hyrat vetanake në Komunën e Graçanicës 2013-2016



Burimi. Zyra Kombëtare e Auditimit

Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna duhet të nis planet për largimin e qenve endacak.
- Komuna duhet të ndërtojë hapësira rekreative sportive dhe këndeve për fëmijë.
- Komuna duhet të hartojë plan për trajtimin e ujerave të zeza dhe evitimin e derdhjes së këtyre ujërave në rrjedhën e lumit.
- Komuna e Graçanicës duhet të ndalë projektet investuese kapitale në objekte që menaxhohen nga ana e strukturave paralele.
- Komuna duhet të shoh shkaqet që kanë qar në rënien e të hyrave komunale dhe të ndërmarr masa për uljen e trendit të rënies së këtyre të hyrave.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world